
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr. 2098/11 prot.

Gjirokastër më 18.12.2025

**RAPORTIMI VJETOR I UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ",
GJIROKASTËR, NË ZBATIM TË UDHËZIMIT NR. 5, DATË
19.02.2018, TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT**

Gjirokastër 2025



PËRMBAJTJA

A. SENATI AKADEMIK.....	5
a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të UGJ-së.....	5
i. Fusha Mësimdhënia.....	14
ii. Fusha Kërkimi Shkencor dhe Veprimtaria Krijuese dhe Inovacioni.....	25
b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitutionale dhe projekte ku merr pjesë UGJ-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.....	38
c) Informacion mbi kërkimin shkencor në UGJ ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:.....	49
i) politikat e kërkimit shkencor.....	49
ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien.....	52
iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit..	53
iv) të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.....	94
d) Të dhëna mbi programet e studimit.....	96
i) UGJ-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.....	97
ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.....	99
iii) UGJ-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme të programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.....	103
e) Ndryshimet në statutin apo rregulloret e UGJ-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....	106
f) Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik.....	109
g) Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që UGJ-ja ofron, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar:.....	121
i) përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar.....	121

ii) përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.....	121
h) Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UGJ-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....	128
i) Vlerësime të UGJ-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të UGJ-së me strukturat e varësisë të ministrisë.....	129
j) një vlerësim të përgjithshëm të komunikimit me ministrinë dhe institucionet në varësi të saj, duke theksuar mbi përmirësimet e mundshme në këtë komunikim.....	129
ii) vlerësime dhe rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore e nënligjore në fuqi që ndikojnë në veprimtarinë e UGJ-së, të shoqëruar me arsyetime të hollësishme.....	130
j) Të dhëna mbi studentët:.....	131
i) numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit.....	131
ii) numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioritetëve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore	132
iii) numrin e studentëve të shkëlqyer.....	132
iv) numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen.....	134
v) numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit.....	135
vi) pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre.....	141
vii) përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen.....	141
viii) një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi.....	144
B. BORDI I ADMINISTRIMIT.....	147
a) Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.....	147
b) Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit.....	152
c) Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.....	164
d) Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.....	173
e) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga UGJ-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.....	175
f) Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimi, në bashkëpunim me Senatin Akademik të institucionit të arsimit të lartë.....	179

TABELAT

A. SENATI AKADEMIK.....	16
Tabela nr. 1: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies.....	16
Tabela nr. 2: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit.....	25
Tabela nr. 3: Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional.....	39
Tabela nr. 4: Mbi Projekte e kërkimit shkencor në të cilat UGJ-ja ka aplikuar për financim.....	50
Tabela nr. 5: Mbi Aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara.....	54
Tabela nr. 6: Mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor.....	94
Tabela nr. 7: Mbi programet e studimit.....	100
Tabela nr. 8: Mbi veprimtarinë e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.....	108
Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik.....	110
Tabela nr. 10: Për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet.....	126
Tabela nr. 11: Mbi përbërjen e Këshillave Studentorë.....	129
Tabela nr. 12: Mbi studentët që kanë qënë anëtarë dhe përfaqësues në organet e UGJ-së.....	129
Tabela nr. 13: Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve.....	132
Tabela nr. 14: Mbi numrin e studentëve të çrregjistruar dhe transferuar.....	134
Tabela nr. 15: Mbi numri i studentëve të ciklit të parë që përfitojnë bursë sipas VKM nr.903, datë 21.12.2016 (përditësuar) të ndara sipas kritereve.....	136
Tabela nr. 16: Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë që paguajnë tarifë (50% ose 100%) sipas VKM nr. 288, datë 21.05.2018 (përditësuar) të ndarë sipas kritereve.....	137
Tabela nr. 17: Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, sipas VKM nr. 269, datë 29.03.2017 (përditësuar) të ndarë sipas kritereve.....	139
Tabela nr. 18: Mbi numrin e studentëve të ciklit të dytë që paguajnë tarifë (50 %) të ndarë sipas kritereve të VKM nr. 780, datë 26.12.2018.....	140
Tabela nr. 19: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre.....	141
B. BORDI I ADMINISTRIMIT.....	151
Tabela nr. 20: Mbi numrin e personelit të UGJ-së.....	151
Tabela nr. 21: Për planin buxhetor afatmesëm.....	161
Tabela nr. 22: Për planin buxhetor njëvjeçar.....	163
Tabela nr. 23: Për realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor.....	168
Tabela nr. 24: Për realizimin faktik të buxhetit nga Granti i Mësimdhënies për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09450, kapitulli 08, artikulli 600–606).....	170
Tabela nr. 25: Për realizimin faktik të buxhetit nga Granti i Punës Kërkimore-Shkencore dhe i Veprimtarive Krijuese për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09770, kapitullin 01, artikulli 604).....	170
Tabela nr. 26: Për realizimin faktik të buxhetit nga Grantit i Politikave të Zhvillimit për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 230-231).....	170
Tabela nr. 27: Për planin buxhetor të vitit pasardhës akademik.....	170
Tabela nr. 28: Për tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim:.....	172
Tabela nr. 29: Mbi mobilitetin e personelit akademik:.....	175
Tabela nr. 30: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore:.....	180



Qëllimi kryesor i Universitetit “Eqrem Çabej” (UGJ-së), Gjirokastrë është të krijojë një mjedis që mbështet dhe integron mësimdhënien, përmirësimin e cilësisë dhe forcimin e mundësive për kërkime shkencore. UGJ-ja synon të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës në territorin e Shqipërisë, nëpërmjet një mësimdhënieje bashkëkohore sipas të gjitha standarteve ndërkombëtare, standarteve evropiane, Deklaratës së Bolonjës, si dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.

A. SENATI AKADEMIK

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë është një universitet i Akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit nr.55, datë 16.12.2021 “Për akreditimin e parë të institucionit të Arsimit të Lartë, Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë me kohëzgjatje 4-vjeçare. Gjatë vitit akademik 2024-2025, UGJ-ja ka përmbyllur aplikimin për akreditimin periodik institucional dhe jemi në fazë aplikimi për akreditimin e 20 programeve të ciklit të dytë të studimeve.

Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare të Universitetit “Eqrem Çabej”, për vitin 2024-2025, ka për qëllim të prezantojë një pasqyrë të qartë të arritjeve, të dobësive si dhe të synimeve që ka për të ardhmen institucionale.

Në hartimin e raportit janë marrë për bazë analiza dhe vlerësime:

- të rezultateve të veprimtarisë së kryer nga organet drejtuese të: Senatit Akademik, Bordit të Administrimit, si dhe nga të gjitha njësitë përbërëse të Rektoratit;
- të veprimtarisë së kryer prej njësive bazë dhe tre fakulteteve;
- të raportit financiar të institucionit për vitin akademik 2024-2025.

Për sa më sipër në hartimin e raportit një ndihmesë ka dhënë ballafaqimi i rezultateve me veprimtarinë e pasqyruar në raportet e viteve të kaluara, pasqyrimi i rezultateve të marra drejtpërdrejt përmes monitorimeve të realizuara nga ana e Rektoratit dhe e gjithë strukturave drejtuese të universitetit, si dhe pasqyrimi i objektivave konkrete që ka Universiteti “Eqrem Çabej” për të ardhmen.

Në hartimin e raportit janë marrë parasysh legjislacioni në fuqi, VKM-të dhe udhëzimet e MAS-it, politikat mbi arsimin e lartë të ndjekura nga Ministria e Arsimit, si dhe tendencat e përgjithshme zhvillimore socio-ekonomike rajonale, kombëtare dhe më gjerë. Ky raport është mbështetur edhe në planin strategjik që Universiteti “Eqrem Çabej” do të hartojë mbi bazën e dokumentit të Arsimit të Lartë 2030, mbi standardet dhe objektivat konkrete për të ardhmen.

Në realizimin e raportit duhet vlerësuar ndihmesa dhe bashkëpunimi i strukturave drejtuese, i të gjithë trupës akademike dhe personelit ndihmësakademik, si dhe në veçanti puna e personelit që bëri të mundur dokumentimin e këtij raporti.

a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të UGJ-së. Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkruese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:



a. Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies

a.1. Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik.

Qëllimi i mësimdhënies në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, sipas Planit Strategjik, është të ofrojë mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore, duke ndjekur standartet ndërkombëtare dhe duke përmirësuar vazhdimisht programet e studimit për të mbështetur përgatitjen akademike të studentëve dhe përparimin e institucionit tonë. Ky angazhim reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në strukturën dhe programet akademike të ofruara nga UGJ-ja, të cilat i përgjigjen nevojave të kohës dhe standarteve ndërkombëtare.

Universiteti “Eqrem Çabej”, ka bërë përparime të dukshme në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies gjatë vitit akademik 2024-2025, duke realizuar hapa të rëndësishëm për të avancuar mësimdhënien në të gjithë fakultetet. Në përputhje me planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër, janë realizuar plane mësimore të përditësuara, është angazhuar personel akademik i kualifikuar dhe janë zhvilluar programe të reja, siç është programi i përbashkët në ciklin e tretë “Doktoratë” në Edukim dhe Shkenca Humane, të përshtatur me standartet europiane dhe nevojat për kërkues shkencor.

Në këtë drejtim, fakultetet e universitetit kanë pasur një angazhim të madh në përmirësimin e ofertës akademike dhe përgatitjen e studentëve për kërkesat e tregut të punës. Ata gjithashtu kanë përdorur literatura bashkëkohore për të pasuruar mësimdhënien dhe kanë zhvilluar programe të dyfishta studimi që promovojnë bashkëpunimin ndërkombëtar. Në këtë kuadër, është integruar gjithashtu edukimi universitar SMART dhe metodat audio-vizive, që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe rrisin angazhimin e studentëve.

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies është i lidhur ngushtë me angazhimin në zhvillimin e infrastrukturës dhe integrimin e moduleve ndërkombëtare, të cilat kanë krijuar kushte optimale për arritjen e standarteve të larta akademike. Universiteti ka forcuar gjithashtu lidhjet me tregun e punës dhe ka rritur ndërgjegjësimin përmes promovimit aktiv të programeve të studimit, duke ndikuar pozitivisht në regjistrimet e reja, duke konsoliduar pozitën e tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Angazhimi për zhvillimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e cilësisë është reflektuar gjithashtu në rritjen e mundësive për mobilitet dhe bashkëpunim ndërkombëtar, përmes projekteve si programet Erasmus+, që kanë kontribuar për zhvillimin e kapaciteteve të studentëve dhe personelit akademik.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse e Universitetit “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës, përmes zhvillimit të programeve akademike, përmirësimit të infrastrukturës dhe promovimit të kërkimit shkencor, siguron përgatitjen e studentëve për një të ardhme të suksesshme dhe kontribuon në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë rajonale dhe ndërkombëtare.

a.2. Strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse.

Për një pasqyrë më të detajuar të qëllimeve dhe objektivave dhe rezultateve të arritura gjatë vitit akademik 2024-2025, për secilin fakultet, referojuni informacionit të mëposhtëm dhe tabelës nr. 1 sipas fakulteteve.



FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE

Politikat strategjike të FESHSH-së, janë hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë, vizionin e universitetit "Eqrem Çabej" dhe Planin Strategjik të UGJ-së. Ato fokusohen në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin e kërkimit shkencor, ndërkombëtarizimin, edukimin në vazhdimësi si dhe në ofrimin e shërbimeve komunitare.

Programet e studimit që ofrohen nga FESHSH-ja, realizohen nga stafi akademik i Njësive bazë, pjesë përbërëse e fakultetit. Gati 80 – 90 % e programeve të studimit mbulohen nga stafet e njësive bazë, me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar, kurse pjesa tjetër mbulohet nga stafi i fakulteteve të tjera, FE-ja dhe FSHN-ja.

Në këtë vit akademik, FESHSH, ka riorganizuar njësinë bazë të Gjuhës Shqipe dhe njësinë bazë të Letërsisë, duke i bashkuar në një njësi bazë të vetme, atë të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë.

E gjithë procedura ka qënë konform akteve ligjore në fuqi, me vendimarrjet përkatëse dhe në përfundim të gjithë procedurës, është njoftuar Ministria e Arsimit dhe është marrë konfirmim nga ana e tyre për këtë riorganizim, duke e pasqyruar këtë riorganizim edhe në sistemin AMS të Agjensisë së Sigurimit të Arsimit të Lartë.

FESHSH-ja ofron programe studimi në ciklin e parë, ciklin e dytë dhe ciklin e tretë të studimeve "Doktoraturë" në Edukim dhe Shkencat Humane në bashkëpunim me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore, si dhe programe me karakter profesional.

Këto programe studimi synojnë përgatitjen e:

a. specialistëve në fushën e gjuhësisë, letërsisë, gjuhëve të huaja, historisë, gjeografisë, trashëgimisë kulturore, edukimit, pedagogjisë dhe fusha të tjera të ndërlidhura me to, në përgjigje dhe në përshtatje me tregun e punës në Shqipëri, të aftë për veprimtari kërkimore-shkencore dhe për aplikime në fusha të tjera të zhvillimit të shoqërisë, duke iu përgjigjur me kompetencë ndryshimeve të shpejta dhe zhvillimit të teknologjisë;

b. mësuesve të gjuhës shqipe dhe letërsisë, gjuhës angleze, historisë dhe gjeografisë, arsimit fillor, arsimit parashkollor, gjuhës, letërsisë dhe qytetërimit grek, mësuesve për arsimin special, me nivel të lartë si nga ana shkencore, ashtu dhe nga ana profesionale e mësimdhënies, të aftë për t'iu përgjigjur sfidave të arsimit dhe shoqërisë;

c. kërkues të rinj në fushën edukimit dhe shkencave humane, kryesisht ato që lidhen me gjuhësinë, letërsinë, edukimin dhe nënfushat e tyre, përmes hartimit dhe angazhimit të personelit akademik në projekte kërkimore, dhe përfshirjes së doktorantëve në këto projekte, për realizimin e programit individual në kuadër të ciklit të tretë të studimeve, por edhe përmes organizimit të veprimtarive që lidhin procesin e mësimdhënies me kërkimin (seminare, workshop-e, leksione të hapura, etj) me studentë të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, si dhe programeve me karakter profesional.

Në këtë aspekt, të gjitha Njësitë bazë pjesë përbërëse të FESHSH-së, harmonizojnë veprimtarinë e tyre të mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra dhe / ose në ndërveprim midis tyre, jo vetëm për shkak të fushave të përafërta që mbulojnë, por edhe në funksion të ndërdisiplinaritetit që promovojnë programet e studimit, si dhe veprimtarive shkencore ku angazhohet personeli akademik, si dhe atyre që organizohen nga FESHSH-ja.



Organizimi dhe struktura e FESHSH-së përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015. FESHSH-ja është e organizuar në njësitë bazë të mëposhtme:

- *Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë* zhvillon veprimtari mësimore dhe kërkimore që përfshijnë fusha kërkimi homogjene në disiplinat mësimore përkatëse, si gjuhësi, letërsi, mësimdhënie në fushën e gjuhësisë shqipe dhe letërsisë, me synimin që të formojë specialistë të lartë kryesisht në mësimdhënie, shkencëtarë në fushat gjuhësore, kulturore dhe letrare, në përshtatje me tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera europiane.

Misioni kryesor i departamentit është garantimi i cilësisë dhe sigurimi i standarteve të larta akademike për të gjitha programet e studimit, jo vetëm përmes metodave bashkëkohore, por kryesisht përmes shkëmbimit të përvojave më të mira. Kërkimi shkencor në këtë departament është i lidhur me forcimin e studimeve albanologjike. Përpos këtyre aspekteve, departamenti luan një rol të veçantë në hulumtimin gjuhësor, kulturor dhe letrar. Departamenti është aktiv në identifikimin e krijimtarisë letrare të autorëve të rinj dhe të vjetër, si dhe promovimin e krijimeve të tyre.

- *Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies* përfshin fusha heterogjene nga shkencat humane dhe shkencat e edukimit. Programet e studimit janë bashkëkohore dhe synojnë të formojnë specialistë të lartë në fushën e mësimdhënies dhe të përgatisin mësuesit e rinj me njohuri të lartë praktike, pedagogjike dhe kërkimore. Nxitja e praktikave të mira që integrojnë mësimin me kërkimin, që përfshijnë studentët në eksperimentimin e metodave inovatore në trajtimin e aftësive ndryshe është fokusi kryesor i departamentit. Ofrimi i shërbimeve në funksion të të tretëve, bashkëpunime me institucionet e arsimit parauniversitar janë prioritet të realizuara nga ky departament.

- *Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë* zhvillon veprimtari mësimore dhe kërkimore në fushën e Historisë, Gjeografisë, Arkeologjisë dhe Antropologjisë me synimin që të formojë specialistë të lartë në këto fusha dhe gjithashtu në fushën e mësimdhënies lidhur me fushat e sipërpërmendura, në përgjigje të kërkesave të tregut të punës në Shqipëri dhe në vendet e tjera perëndimore. Misioni kryesor i këtij departamenti është garantimi i cilësisë dhe sigurimi i standarteve të larta akademike për të gjitha programet që ofron. Bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit për ndërkombëtarizimin e programeve dhe veprimtarisë shkencore bëhet kryesisht përmes pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, mobiliteteve për stafin dhe studentët, të cilat kanë mundur përshtatjen e programeve të studimit ndaj kërkesave të kohës, nxitjen, mbështetjen dhe zhvillimin e aktivitetit të kërkimit shkencor të stafeve dhe studentëve.

- *Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek*, e zhvillon veprimtarinë mësimore dhe kërkimore në fushën e gjuhësisë, letërsisë dhe qytetërimit grek me synimin që të formojë specialistë të lartë në këto fusha dhe mësues të cilët do të shërbejnë në shkollat e minoritetit etnik grek. Departamenti luan një rol të rëndësishëm në funksion të hulumtimit kulturor, gjuhësor dhe letrar në gjuhën greke. Nxitja e praktikave të mira që integrojnë mësimin me kërkimin, që përfshijnë studentët në eksperimentimin e metodave inovatore në mësimdhënie për pakicën etnike greke është një prioritet i realizuar nga ky departament.



- *Departamenti i Gjuhëve të Huaja* zhvillon veprimtari mësimore-kërkimore në fusha kërkimi sipas disiplinave përkatëse si: Gjuhësi, Letërsi dhe studime kulturore, mësimdhënie të gjuhës së huaj, përkthim, interpretim dhe komunikim, me synimin që të formojë specialistë të lartë kryesisht në mësimdhënie, përkthim, interpretim, komunikim, në përshtatje me tregun kombëtar dhe perëndimor të punës. Misioni i departamentit është garantimi i cilësisë së mësimdhënies dhe sigurimi i standarteve të larta akademike për programet që ofron. Bashkëpunimi me departamentet brenda dhe jashtë vendit për ndërkombëtarizimin e programeve dhe aktivitetit shkencor realizohet kryesisht përmes projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, mobiliteteve për stafin dhe studentët, të cilat kanë mundësuar arritjen e objektivave të departamentit.

Objektivat kryesore për vitin akademik 2024-2025 në FESHSH janë të organizuara rreth tre shtyllave kryesore:

1. rritja e nivelit të cilësisë së mësimdhënies nga ana e personelit akademik për të mbështetur të mësuarit aktiv, mendimin kritik tek studentët, lidhjen me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, përfshirjen e studentëve në kërkim për të rritur cilësinë dhe përvetësimin e njohurive për zbatimin në praktikë dhe për inovacionin.
2. Kualifikimi i vazhdueshëm shkencor i personelit akademik dhe përmirësimi i metodave dhe teknikave të mësimdhënies.
3. Përshtatja e vazhdueshme e programeve të studimit të ofruara me nevojat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.

Këto objektiva janë përmbushur përmes:

1. përmirësimit të mëtejshëm të infrastrukturës (laboratori për zhvillimin e praktikave pedagogjike për studentët në programet e mësuesisë);
2. përdorimit të teknologjisë së informacionit për realizimin e disa veprimtarive formuese;
3. përfshirjes së personelit akademik në shkëmbimet Erasmus+ në departamente të FESHSH-së;
4. shkëmbimit të përvojave, vendëse dhe të huaja përmes mobiliteteve për mësimdhënie / trajnim nga ana e personelit akademik, por edhe përmes aktiviteteve tematike në fushën e edukimit;
5. numrit të publikimeve nga ana e personelit akademik;
6. numrit të aplikimeve nga personeli për thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare për projekte kërkimore dhe zhvillimore;
7. aplikimeve për hapje/riorganizime të programeve të studimit, ku në vitin akademik 2024–2025 janë realizuar: riorganizimi i planeve mësimore deri në masën 20% për programet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve. Ky riorganizimi ka konsistuar në përfshirjen e praktikës profesionale në programet e ciklit të parë, e cila rrjedhimisht ndërthur kurrikulat më shumë me kërkesën e tregut të punës, për më shumë kompetenca praktike;
8. fillimin e punës për procesin e akreditimit për të gjitha programet e ciklit të dytë dhe programet me karakter profesional, të cilat e kanë akreditimin e parë;
9. angazhimit maksimal të njëjësive përbërëse të FESHSH-së në kuadër të Programit Kombëtar të Zhvillimit të Mësuesve duke realizuar me sukses module trajnimi sipas fushave përkatëse.

Personeli akademik i FESHSH-së sipas njësive bazë paraqiten në tabelën e mëposhtme për vitin akademik 2024-2025:

Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë	13	5	10
Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë	13	0	0
Departamenti i Gjuhëve të Huaja	12	0	0
Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	9	9	2
Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek	9	0	0
Total FESHSH	56	14	12

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë	9	2	2
Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë	3	8	2
Departamenti i Gjuhëve të Huaja	5	4	3
Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	1	5	3
Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek	1	2	6
TOTAL FESHSH	19	21	16

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Qëllimi i mësimdhënies në Fakultetin e Shkencave të Natyrës është të formojë specialistë të lartë në fushën e infermierisë, teknologjisë së informacionit, shkencave Biologji-Kimi dhe mësimdhënies në fushën e bio-kimisë, të kualifikuar dhe të përshtatshëm me tregun rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.

Në përfundim të vitit akademik 2024-2025 bëhet bilanci në lidhje me arritjet e objektivave në mësimdhënie sipas planit strategjik të fakultetit:

1. Realizimi i planeve mësimore në të gjitha programet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë. FSHN-ja ka ofruar me kapacitet të plotë të gjitha programet e studimit Bachelor, Master Profesional dhe Master i Shkencave. Procesi mësimor është ofruar bazuar në strukturën e vitit akademik dhe mbështetur në planet mësimore të çdo programi studimi. Koordinimi i praktikave mësimore me leksionet/ seminarët/ ushtrimeve/ laboratorëve sipas lëndëve ka qënë i kënaqshëm duke u krijuar të gjithë studentëve hapësirat e mjaftueshme për zhvillimin e të gjitha veprimtarive mësimore.
2. Realizimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik të FSHN-së. Personeli akademik i FSHN-së ka realizuar me korrektësi kohën vjetore të punës në përputhje me marrëveshjen e orëve të punës të planifikuara dhe të realizuara për vitin akademik 2024-2025, midis personelit akademik dhe përgjegjësve të njësive bazë për ngarkesën e realizuar, mësimdhënien e normuar vjetore, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale.
3. Përgatitja e literaturës bazë dhe rishikimi i syllabuseve në programet e studimit. Për të gjitha lëndët e ciklit të parë Bachelor dhe programeve të ciklit të dytë të studimeve ka literaturë të konsoliduar në dispozicion të studentëve. FSHN-ja ka integruar literaturën online duke vënë në funksionim bibliotekën online Jstore, si dhe aksesin në revista shkencore online.

Titullarët e lëndëve angazhohen për rishikimin e literaturës dhe përgatitjen e syllabusit para fillimit të vitit akademik në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Angazhimi i stafit akademik të kualifikuar në mësimdhënie.

Personeli akademik i FSHN-së sipas njësive bazë paraqiten në tabelën e mëposhtme për vitin akademik 2024-2025:

Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Njësia bazë e Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe ushqimit	8	8	2
Njësia bazë e Matematikës Informatikës dhe Fizikës	11	5	1
Njësia bazë e Infermierisë	10	10	1
TOTAL FSHN	29	23	4

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Njësia bazë e Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe ushqimit	5	3	0
Njësia bazë e Matematikës Informatikës dhe Fizikës	4	5	3
Njësia bazë e Infermierisë	1	4	5
TOTAL FSHN	10	12	8

- Bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave mësimore. Për programet e infermierisë (cikli I / II) është krijuar partneritet me një rrjet spitalësh rajonale dhe Drejtorinë e Shërbimit Parësor, në funksion të kryerjes së praktikës profesionale, përgjatë vitit akademik 2024-2025, ku studentët gjatë praktikës së tyre ndiqen nga pedagogët përkatës. Gjithashtu për programet e studimit Bachelor në Biologji – Kimi dhe Master në mësuesi për AMU në Biologji Kimi, viti i dytë (në vitin 2024-2025 ky program është riorganizuar në Master i Shkencave në mësuesi në Biologji-Kimi), praktikat mësimore kryhen në shkollat e arsimit parauniversitar dhe gjithashtu kanë praktika në terren, ndërsa studentët e programit të studimit në Teknologji Informacioni pjesën praktike e kryejnë në laboratorët digjitalë pranë UGJ-së.
- Riorganizimi i planeve mësimore deri në masën 20 %. Duke marrë në konsideratë, të gjitha rekomandimet nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm për programet e studimit në këtë fakultet, të gjitha departamentet që ofrojnë programe studimi, ngritën grupe pune brenda departamentit hartuan gjithë dokumentacionin për riorganizimin e pjesshëm të planeve mësimore. Ky riorganizim konsiston në përfshirjen e praktikës profesionale në të gjitha programet e studimit sipas raportit të përcaktuar në VKM-në përkatëse.
- Ndërkombëtarizimi i FSHN-së. Marrëveshjet institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare që janë nënshkruar në nivel institucional, kanë bërë të mundur që në sajë të programeve Erasmus+ për mobilitetet staf/studentë, një numër i konsiderueshëm studentësh dhe stafi kanë kryer mobilitetet për këtë vit akademik, duke bërë të mundur zhvillimin e një semestri në universitetet partnere.
- Aplikimet për projekte. Viti akademik 2024-2025 ka rezultuar i suksesshëm në numrin e stafit që ka aplikuar për thirrjet për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.



Vizioni dhe objektivat e Fakultetit të Shkencave të Natyrës ngelen gjithmonë edukimi dhe përgatitja e profesionistëve të rinj që mbulojnë sektorët strategjikë të zhvillimit rajonal dhe kombëtar, duke aspiruar të ndërtojmë një mjedis korrekt në edukimin e brezave të rinj. Misioni i FSHN-së synon zhvillimin, transmetimin dhe mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve.

Objektivat e FSHN-së përqëndrohen në përgatitjen e infermierëve të ardhshëm, specialistëve të teknologjisë së informacionit, specialistëve në fushën e shkencave biologjike dhe kimistëve të ardhshëm, si dhe gjithashtu në përgatitjen e mësuesve të ardhshëm për Biologjinë dhe Kiminë.

Prioritetet e FSHN-së janë në harmoni me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë duke vënë theksin në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimit të kërkimit shkencor, edukimit në vazhdimësi dhe ofrimin e shërbimeve komunitare.

FAKULTETI EKONOMIK

Politikat strategjike të Fakultetit Ekonomik, janë hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë, vizionin e UGJ-së, si dhe mbështetur në planin strategjik të Universitetit Eqrem Çabej, të cilat fokusohen në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin.

Qëllimi i mësimdhënies në FE është të formojë specialistë të lartë në fushën e ekonomisë, turizmit dhe administratës publike, të kualifikuar dhe të përshtatshëm për tregun e punës kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2024-2025 arritjet e objektivave të mësimdhënies mbështetur në planin strategjik në FE-së, ka qënë i fokusuar në përmbushjen e misionit të tij në përgatitjen, formimin dhe diplomimin e specialistëve të kualifikuar dhe të aftë në fushën e Financës dhe Kontabilitetit, Turizmit dhe Specialistëve në administratën Publike në përputhje me kërkesat e tregut të punës në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin rajonal dhe kombëtar, por edhe atë europian.

Përmes angazhimit aktiv me njësitë e biznesit, njësitë bazë të FE-së, kanë qënë të përkushtuara në avancimin e të kuptuarit të fushës së ekonomisë dhe rolit të tyre në shoqëri:

1. Akreditimi i programeve të studimit në funksion të rritjes së cilësisë.
2. Orientimi drejt rritjes së cilësisë së mësimdhënies është reflektuar në përmbylljen me sukses të akreditimit të programeve të ciklit të parë, dhe ciklit të dytë që ky departament ofron. Nga raportet e vlerësimit të jashtëm rezulton një performancë shumë pozitive për këto programe studimi.
3. Ndërkombëtarizimi i FE-së. Marrëveshjet institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare që janë nënshkruar në nivel institucional, kanë bërë të mundur që në sajë të programeve Erasmus+ për mobilitetet staf / studentë, një numër i konsiderueshëm studentësh dhe stafi kanë kryer mobilitetet për këtë vit akademik duke bërë të mundur zhvillimin e një semestri në universitete partnere. Gjithashtu FE-ja në kuadër të ndërkombëtarizimit ofron 2 (dy) programe të përbashkëta me 2 (dy) universitete italiane (Salentos dhe Molises) në ciklin e parë Bachelor.



4. Aplikimet për projekte. Viti akademik 2024-2025 ka rezultuar i suksesshëm në numrin e stafit që ka aplikuar për thirrjet për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
5. Kualifikimi i personelit akademik. Puna kërkimore-shkencore e personelit akademik në funksion të kualifikimit dhe marrjes së titujve dhe gradave shkencore ka qënë një nga objektivat e arritura në këtë vit akademik.
6. Literatura bazë dhe mbështetëse. Përdorimi i literaturës dhe teknikave bashkëkohore dhe përdorimi i metodave interaktive në mësimdhënie ka shënuar rritje të kënaqshme.
7. Bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale. Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis sektorit privat dhe atij publik në funksion të realizimit të praktikave profesionale ka qënë frytdhënës për studentët e FE-së.
8. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies. Hartimi i pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie për programet e studimit ka dhënë impaktin e vet në hartimin e raportit të cilësisë duke evidetuar praktikën e mira, gjetjet dhe pikat e dobëta, të cilat kanë nevojë për përmirësim. Vizioni dhe objektivat e FE-së ngelen gjithmonë edukimi dhe përgatitja e profesionistëve të rinj që mbulojnë sektorët strategjikë të zhvillimit rajonal e kombëtar, duke aspiruar të ndërtojmë një mjedis korrekt në edukimin e brezave të rinj. Misioni i FE-së synon zhvillimin, transmetimin dhe mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve.
9. Riorganizimi i planeve mësimore deri në masën 20 %. Duke marrë në konsideratë, të gjitha rekomandimet nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm për programet e studimit në këtë fakultet, të gjithë departamentet që ofrojnë programe studimi, ngritën grupe pune brenda departamentit dhe hartuan gjithë dokumentacionin për riorganizimin e pjesshëm të planeve mësimore. Ky riorganizim konsistoi në përfshirjen e praktikës profesionale në të gjitha programet e studimit sipas raportit të përcaktuar në VKM-në përkatëse. Objektivat e FE-së përqëndrohen në përgatitjen e financierëve, kontabilistëve, specialistëve në fushën e turizmit, si dhe gjithashtu specialistëve në administratën publike.

Personeli akademik i FE-së sipas njësive bazë paraqiten në tabelën e mëposhtme për vitin akademik 2024-2025:

Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Njësia bazë e Kontabilitet-Financë	8	5	1
Njësia bazë e Administrimit Publik	9	6	2
Njësia bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit	9	2	2
Total FE	26	13	5

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Njësia bazë e Kontabilitet-Financës	2	5	1
Njësia bazë e Administrimit Publik	2	4	3
Njësia bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit	3	1	5
TOTAL FE	7	10	9



i. Fusha Mësimdhënia

Qëllimi: (Të përcaktohet qëllimi i UGJ-së në lidhje me këtë fushë të veprimtarisë së tij)

Qëllimi i mësimdhënies në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, sipas Planit Strategjik, është të ofrojë mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore, duke ndjekur standartet ndërkombëtare dhe duke përmirësuar vazhdimisht programet e studimit për të mbështetur përgatitjen akademike të studentëve dhe përparimin e institucionit të UGJ-së. Ky angazhim reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në strukturën dhe programet akademike të ofruara nga UGJ-ja, të cilat i përgjigjen nevojave të kohës dhe standarteve ndërkombëtare.

Nga analizat e kryera në universitetin "Eqrem Çabej" në rang njesish kryesore / njësi bazë dhe më pas përgatitja e raportit vjetor për vitin akademik në rang fakultetesh (FSHN, FESHSH dhe FE) në lidhje me procesin mësimor vihet re:

FAKULTETI E EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE

Në lidhje me proceset që lidhen me mësimdhënien, stafi i FESHSH-së ka realizuar objektivat sipas planit strategjik:

1. Realizimi i plotë i procesit mësimor të vitit akademik 2024-2025.
2. Realizimi i raporteve të vlerësimit të brendshëm sipas programeve të studimit.
3. Aplikim dhe miratimi nga MA për riorganizim të programit të ciklit të dytë.
4. Aplikim dhe miratimi nga MA për riorganizim të programit të ciklit të parë.
5. Aplikimi pranë MA i kuotave për programin e cikut të tretë sipas akteve ligjore në fuqi.
6. Hartimi i dokumentacionit të vitit akademik.
7. Hartimi dhe dorëzimi i marrëveshjes për planifikimin e kohës vjetore të punës.
8. Përgatitja e programeve të lëndëve (syllabuseve) për çdo program studimi.
9. Përmirësimi i materialeve mësimore të lëndëve sipas çdo programi për të qënë koherent me kërkesat e teknologjisë së prezantimit dhe të informimit sipas përmbajtjes.
10. Hartimi i leksioneve, cikël leksionesh, maket tekstesh mësimore dhe laboratorike bashkëkohore në informacion dhe konceptim.
11. Hartimi i orareve mësimore për çdo semestër.
12. Diskutimi/shpërndarja e ngarkesës mësimore dhe miratimi i ngarkesës së parashikuar dhe hartimi i dokumentacionit për ngarkesën e realizuar.
13. Hartimi i dhe miratimi i tezave të provimeve sipas lëndëve të planit mësimor.
14. Koordinimi midis orëve teorike të realizuara në auditoret e UGJ-së dhe orëve praktike në efikasitet të plotë.
15. Organizimi i praktikave / ekspeditave sipas programeve të studimit dhe ndjekja e tyre nga pedagogët përkatës.
16. Vazhdimi i procesit të kualifikimit të stafit akademik në të gjitha nivelet dhe drejtimet.
 - Pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare
 - Botime në periodikë shkencorë brenda dhe jashtë vendit.
17. Plotësimi i saktë dhe në kohë, si dhe ruajtja e dokumentacionit përkatës për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.



18. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga stafi dhe infrastrukturës së sallave të mësimi për studentët.
19. Marrja e masave për minimizimin e problematikave të konstatuara për frekuentimin e orëve në auditor.
20. Puna me planet e veprimtarisë kërkimore shkencore.
21. Sigurimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucione të tjera universitare brenda dhe jashtë vendit si dhe institucione të administratës publike dhe sektorit privat.
22. Dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat e udhëzimet e MA.
23. Hartimi i rregullores së fakultetit dhe programeve përkatëse të studimit.
24. Hartimi i strukturës së vitit akademik.
25. Realizimi konform rregullores i provimeve dhe formave të tjera të kontrollit. Provimet janë zhvilluar konform rregullores dhe sipas kalendarit të provimeve të përcaktuar nga njësitë bazë.
26. Kemi menaxhuar problematikën me zyrën e financës për pagesat e tarifave të shkollimit.
27. Rekrutimi prej departamenteve i stafit akademik të nevojshëm, duke ndjekur procedura ligjore dhe transparente, në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.
28. Aktivizimi për nevojat e departamenteve me pedagogë me kohë të pjesshme, të cilët zhvillojnë kryesisht orë seminaresh apo ndjekje të praktikave pedagogjike e profesionale të studentëve, etj.
29. Sigurimi i asistencës së nevojshme për të gjithë studentet e diplomuar, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe kualifikimin e mëtijshëm të tyre.
30. Realizimi në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale dhe mësimore sipas specifikave të programit dhe grupeve mësimore.
31. Riorganizimi, diskutimi dhe miratimi i programeve mësimore, kryesisht të lidhura me programin e ciklit të parë dhe të dytë, në zbatim të ligjit të IAL-së dhe udhëzimeve të MASR-së.
32. Menaxhimi i gjithë procesit të regjistrimeve të reja për vitin 2024-2025 në bashkëpunim me SSKC që është strukturë pranë Rektoratit të UGJ-së.
33. Angazhimi aktiv në plotësimin e pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies dhe pyetësorit për vlerësimin e praktikave mësimore nga ana e studentëve të fakultetit.
34. Angazhim nga stafi për thirrjet e hapura për projekte kërkimore dhe aplikimi pranë AKKSHI-t.
35. Angazhim i stafit të FESHSH-së në trajnimin e mësuesve në kuadër të programit të zhvillimit profesional të mësuesve.

Problematikat dhe përmirësimet që nevojiten në aspektin e mësimdhënies mbeten detyrë dhe do të jenë në objektivat e vitit të ardhshëm akademik.

Natyrisht funksionimi normal i programeve të ndryshme të studimit në fushën e mësimdhënies lidhet ngushtë me numrin e studentëve të regjistruar, i cili në disa programe studimi, kryesisht në programet e mësuesisë është disi i ulët.



Tabela nr. 1: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Objektivi I : Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies FESHSH						
Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti / Drejtoria / Sektori Përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Hartimi i dokumentacionit për fillimin e vitit akademik 2024-2025	Diskutime në çdo njësi bazë dhe njësi kryesore	Njësitë Kryesore, Njësitë bazë Sektori i Standarteve të cilësisë dhe Kurrikulave	Realizuar	Shtator – Tetor 2024	Përmbyllja e dokumentacionit dhe dorëzimi i dokumentacionit pranë Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave
2	Procesi i regjistrimeve të reja për vitin akademik 2024-2025	Ngritja e grupeve të punës për pranimet e reja për vitin akademik 2024-2025	Njësi kryesore Kryesekretari Sekretari mesimor të njësisë kryesore Sektori i Standarteve të cilësisë dhe kurrikulave	Realizuar	Shtator – Nëntor 2024	Përmbyllje e procesit dhe dërgimi i listës së studentëve pranë QSHA
3	Riorganizimi i pjesshëm i programeve të studimit	Përgatitja e gjithë dokumentacionit dhe dërgimi i aplikimit pranë Ministrisë	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore Njësitë bazë Sektori i Standarteve dhe Kurrikulave	Realizuar Konfirmuar nga MA	Dhjetor 2024 Prill 2025	Realizuar me ardhjen e konfirmimit nga MA
4	Përgatitja e pyetësorit për procesin mësimor	Hartimi i pyetësorit Ngritja e grupit të punës dhe përgatitja e analizës së pyetësorit pas rezultateve	Rrektori Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave	Realizuar	Mars 2025 – Korrik 2025	Realizuar me studentët e UGJ-së në të gjitha ciklet
5	Përgatitja e pyetësorit për vlerësimin e praktikave profesionale	Hartimi i pyetësorit Ngritja e grupit të punës dhe përgatitja e analizës së pyetësorit pas rezultateve	Rrektori Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave	Realizuar	Mars 2025 – Korrik 2025	Realizuar me studentët e UGJ-së në të gjitha ciklet
6	Planifikimi dhe Realizimi i kohës vjetore të punës	Organizimi është kryer duke harmonizuar ngarkesën për mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale. Realizimi i gjithë procesit mësimor – kërkimor për këtë	Formalizimi në fillim të vitit akademik midis personelit akademik dhe përgjegjësit të njësisë bazë dhe dorëzimi i marrëveshjes që për ngarkesën e realizuar për	Realizuar	Tetor 2024 përfunduar në korrik 2025	Dokumentacion i depozituar pranë njësisë bazë

		vit akademik	mësimdhënien e normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale			
7	Rishikimi dhe dorëzimi i programeve lëndore (syllabuseve) nga titullari i lëndës	Titullarët e lëndëve kanë përgatitur programet e lëndëve duke rishikuar literaturën bazë dhe atë mbështetëse para fillimit të vitit akademik	Njësitë kryesore Njësitë bazë Sektori i Standarteve dhe Kurrikulave	Realizuar	Tetor 2024 para fillimit të vitit akademik	Realizuar dhe dokumentacioni i dorëzuar pranë njësive bazë dhe SSCK
8	Monitorimi i procesit mësimor dhe sezoneve të provimeve	Organizimi i punës nëpërmjet grupit qëndror të ngritur nga Rektori me qëllim mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimdhënës	Rektorati Njësitë Kryesore Sektori i Standarteve të Cilësisë	Realizuar	Gjatë gjithë vitit akademik 2024-2025	Realizuar dhe dokumentuar nëpërmjet raportit të monitorimit
9	Monitorimi i praktikave profesionale / mësimore të zhvilluara sipas programeve të studimit	Organizimi i punës nëpërmjet grupit qëndror të ngritur nga Rektori me qëllim mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimdhënës	Rektorati Njësitë Kryesore Sektori i Standarteve të Cilësisë	Realizuar	Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2024-2025	Realizuar dhe dokumentuar nëpërmjet raportit të monitorimit
10	Angazhim i personelit akademik në trajnimet e mësuesve të sistemit parauniversitar	Programi kombëtar i zhvillimit profesional të mësuesve	Njësitë kryesore Njësitë bazë Koordinatori i UGJ-së për ASCAP	Realizuar	Qershor 2024- Tetor 2025	Realizuar dhe raportuar pranë ASCAP
11	Angazhim i personelit akademik për trajnimet për modulet e aplikuar pranë ASCAP për mësuesit	Trajnimet e mësuesve të sistemit parauniversitar	Njësitë kryesore Njësitë bazë Koordinatori i UGJ-së për ASCAP	Realizuar	Gjatë vitit akademik 2024-2025	Realizuar dhe raportuar pranë ASCAP
12	Aplikimi për miratimin e kuotave për programin e përbashkët për ciklin e tretë në bashkëpunim me universitetin e Maqedonisë Perëndimore	Realizimi dhe miratimi i udhëheqjeve	FESHSH dhe njësitë përbërëse të saj në bashkëpunim me SSCK dhe Universitetin partner të Maqedonisë Perëndimore	Realizuar	Finalizuar në Korrik 2025	Miratuar nga MAS
13	Erasmus +	Aplikimi i stafit në programet Erasmus +	FESHSH Sektori i marrëdhënieve me jashtë dhe kërkimit shkencor	Realizuar	Gjate vitit akademik	Mobilitete stafi



Kapacitetet pritëse të FESHSH-së.

Infrastruktura e disponueshme është e përshtatshme për krijimin e një mjedisi pune dhe mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit akademik, ndihmësakademik në mënyrë profesionale dhe me standarte. Mësimi për FESHSH-në zhvillohet në Godinën B dhe pjesërisht në Godinën A dhe C. Në funksion të mësimdhënies për stafin dhe studentët ndodhen auditorët të pajisura me mjetet e duhura digjitale, laboratorët të cilët kanë teknologji bashkëkohore, një bibliotekë e gjuhëve të huaja

Të gjithë laboratorët janë të pajisura me kompjutera, projektor dhe internet në gjithë godinën.

Raporti i kapaciteteve pritëse për vitin 2024-2025, i miratuar edhe nga MAS, paraqitet si më poshtë vijon:

- a. pedagog / student është 1 pedagog / 20 student
- b. sipërfaqe /student plotëson normativën 2.7 m^2 / student.

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nga analizat e kryera në rang departamentesh dhe më pas përgatitja e raportit vjetor për vitin akademik në fakultetin e shkencave të natyrës në lidhje me procesin mësimor vihet re:

1. Realizimi i plotë i procesit mësimor të vitit akademik 2024-2025.

Në një vlerësim të përgjithshëm gjatë vitit akademik, në të tre njësitë bazë, ka vazhduar me sukses veprimtarinë e tij në tre shtyllat kryesore: veprimtaria akademike, aktiviteti shkencor dhe shërbimet komunitare. Ky ka qënë një vit i suksesshëm për stafin në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, aktivitetet trajnuese/ projektet dhe mobilitetet.

2. Hartimi i dokumentacionit të vitit akademik sipas planifikimit kohor dhe përmirësimi i programeve lëndore për lëndët përkatëse.

3. Përmirësimi i materialeve mësimore të lëndëve sipas çdo programi për të qënë koherent me kërkesat e teknologjisë së prezantimit dhe të informimit sipas përmbajtjes.

4. Hartimi i leksioneve, cikël leksionesh, maket tekstesh mësimore bashkëkohore në informacion dhe konceptim.

5. Vazhdimi i procesit të kualifikimit të stafit akademik në të gjitha nivelet dhe drejtimet.

-Pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

-Botime në periodikë shkencorë brenda dhe jashtë vendit.

6. Plotësimi i saktë dhe në kohë, si dhe ruajtja e dokumentacionit përkatës për mbarëvatjen e procesit mësimor dhe aktivitetit të kërkimit shkencor.

Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Departamenti i Antropologjisë, Historisë dhe Gjeografisë	13	5	10
Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë	13		
Departamenti i Gjuhëve të Huaja	12		
Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	9	9	2
Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek	9		
Total FESHSH	56	14	12

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Departamenti i Antropologjisë, Historisë dhe Gjeografisë	9	2	2
Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë	3	8	2
Departamenti i Gjuhëve të Huaja	5	4	3
Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	1	5	3
Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek	1	2	6
TOTAL FESHSH	19	21	16

Nga pikëpamja e strukturës së stafit akademik, FSHN-ja plotëson të gjitha standartet ligjore të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme për vitin akademik 2024-2025.

Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit	8	8	2
Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	11	5	1
Departamenti i Infermierisë	10	10	1
TOTAL FSHN	29	23	4

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit	5	3	0
Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	4	5	3
Departamenti i Infermierisë	1	4	5
TOTAL FSHN	10	12	8

Personeli akademik i FE-së sipas njësive bazë paraqiten në tabelën mëposhtme për vitin akademik 2024-2025:

Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Departamenti i Kontabilitet-Financë	8	5	1
Departamenti i Administrimit Publik	9	6	2
Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit	9	2	2
TOTAL FE	26	13	5

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Departamenti i Kontabilitet-Financë	2	5	1
Departamenti i Administrimit Publik	2	4	3
Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit	3	1	5
TOTAL FE	7	10	9

Tabela nr. 20: Mbi numrin e personelit të UGJ-së.

Nr	Fakulteti/ Institucioni	Departament/ Qendër	Nr. personeli					
			Akademik				Ndihmës Akademik i ftuar	Administrativ
			Prof.	Prof.ass	Lektor	Ass.Lektor		
1	FESHSH	Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë						2
2		Departamenti i Antropologjisë, Historisë dhe Gjeografisë	0	3	8	2	0	0
3		Departamenti i Gjuhëve të Huaja						
4		Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek	6	3	2	2	1	10
5		Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	0	5	4	3	0	1
6	FSHN	Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	0	1	2	6	0	0
7		Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit	0	1	5	3	0	2
8		Departamenti i Infermierisë						2
9	FE	Departamenti i Kontabilitet-Financë	0	4	5	2	1	1
10		Departamenti i Administrimit Publik	1	4	3	0	2	2
11		Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit	0	1	4	5	2	1

Sqarim:

Tek të dhënat për personel akademik janë pasqyruar personeli akademik i brendshëm dhe i ftuar për secilën njësi bazë.

Tek të dhënat për personel ndihmësakademik janë pasqyruar sekretarët mësimorë dhe asistentët e dekanit për secilën njësi kryesore.



b) Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit.

Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkruese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë tabelat, sipas modeleve të parashikuara në aktet nënligjore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financës.

RELACION MBI PARASHIKIMIN E PROJEKT-BUXHETIT AFATMESEM 2026-2028

I- Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të ligjit Nr.115/2024 “Për Buxhetin e Vitit 2025”, VKMnr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, është hartuar materiali i Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026-2028. Për përgatitjen e programit buxhetor 2026-2028, janë plotësuar formularët sipas Aneksit 7-A, parashikimin e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, të shoqëruara me një përshkrim/relacion të shkurtër. Gjatë përgatitjes së PBA është pasur pasur parasysh Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 si edhe nenin 109 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimit të Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, ku shprehet se Institucionet Publike të Arsimit të Lartë financohen nga:

- Buxheti i shtetit.
- Pagesat e tarifave nga studentët për arsimim.
- Të ardhurat për shërbimet e kryera.
- Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta.
- Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi.
- Veprimtari kërkimore-shkencore.

duke pasur si prioritet:

- Përmirësime të mëtejshme në infrastrukturë.
- Kërkime dhe studimet shkencore.
- Lidhje komunitare, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Qeverisjen bashkëkohore.

Në zbatim të udhëzimit nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, financimi nga Granti bëhet me bazë studentin, duke i konvertuar në njësi financimi sipas koeficientëve të financimit të përlllogaritura mbi bazë të programeve të studimit dhe koston mesatare për student. Ky fond përlllogaritet çdo vit nga MA-it dhe dërgohet në institucion në formë Grandi nga Buxheti i Shtetit.

Për planifikimin e projekt buxhetit për vitin 2026-2028, janë përlllogaritur shpenzimet për:

- Pagat.
- Shpenzimet operative.
- Investimet.



Në paraqitjen analitike të zërave të buxhetit janë përcaktuar edhe burimet e financimit për çdo artikull të tij, ku një pjesë janë planifikuar nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe një pjesë janë planifikuar nga të ardhurat dytësore të pritshme.

Për vitin 2026 parashikohet të shpenzohen në mënyrë të ndërthurur për:

- Paga dhe sigurime shoqërore.
- Për mallra dhe shërbime për funksionim të institucionit.
- Për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës për kërkim shkencor.
- Për investime.

Duke parë ecurinë e të ardhurave të krijuara si dhe të shpenzimeve të domosdoshme gjatë viteve të fundit, Granti i akorduar nga Buxheti i Shtetit mbetet burimi kryesor i financimit për Universitetin. Për vitin 2025 nga MA-it u akordua Grandi në vlerën prej 293.228.000lek, i cili mbulon pjesën kryesore të pagave. Për arsye se pagat e stafit akademik patën rritje gjatë vitit 2025, në zbatim të vendimit të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, referuar VKM -së nr 243, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.6.2009”, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, një pjesë e pagave do të likujdohet nga të ardhurat e krijuara gjatë vitit 2025. Transferta e pakushtëzuar e llogaritur për vitin 2026 mbulon fondin e nevojshëm për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe një pjesë të shpenzimeve operative. Gjithashtu një pjesë e transfertës në vlerën prej 16.500.000lek është planifikuar për bursat. Ky fond është i mjaftueshëm për likuidimin e bursave të studentëve për vitin akademik 2025-2026, si dhe për pagesat e bursave që kryhet për periudhën tetor-dhjetor 2026, për studentët përfitues, në vitin akademik 2026-2027. Fondet e bursave nuk mund të alokohen për shpenzime të tjera, por mbarten në vitin pasardhës.

Për vitin 2026 parashikojmë si më poshtë vijon:

I-FINANCIM NGA BUXHETI I SHTETIT

Në zbatim të nenit 110 “Shpërndarja e fondeve nga Buxheti i Shtetit” të ligjit nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë shprehet se këto fonde do të jepen në formë grandit, sipas kategorive:

- Granti i mësimdhënies (85 % të fondit vjetor),.
- Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë (10% të fondit vjetor).
- Granti i punës kërkimore - shkencore dhe veprimtarive krijuese (5% të fondit vjetor).

Granti i politikave të zhvillimit të institucioneve publike të Arsimit të Lartë, jepet për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike dhe akordohet nga MA-ik/(AKFAL). Fondi shpërndahet mbi bazën e renditjes së Institucioneve publike të Arsimit të Lartë. Pavarësisht se sa mund të jetë niveli i grantit, UGJ-ja ka planifikuar fonde që të mbulojnë nevojat reale të institucionit.

1.1 PLANIFIKIM I FONDEVE PËR PAGA

Fondi i pagave përlllogaritet në bazë të strukturës organike aktuale të Universitetit si dhe derdhjes së detyrueshme për çdo muaj të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi.

Për llogaritjen e pagave është marrë në konsideratë vënia në zbatim e Vendimit nr. 243, datë 20.4.2023 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 20.4.2023 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimnr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve”, VKM nr 422 datë 26.06.2024, Vendimin nr. 325, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar me VKM nr 421, datë 26.06.2024, duke patur parasysh faktet si më poshtë vijon: strukturën organike aktuale të miratuar në fillim të vitit; kualifikimin e stafit akademik në vazhdim.

Për të gjithë të punësuarit pranë institucionit ku përfshihen stafi akademik, ndihmësakademik si dhe personeli administrativ planifikohet fond page bruto në vlerën prej 308.466.000lek, sipas llogaritjes së pagës maksimale në VKM nr 243 datë 20.04.2023 për pagën e stafit akademik, si dhe duke patur parasysh VKM nr. 421 dhe VKM nr. 422, datë 26.06.2024 në llogaritjen e pagave të punonjësve ndihmësakademik me karakter akademik, ndihmësakademik me karakter administrativ dhe punonjës mbështetës.

I-2 PLANIFIKIM I FONDEVE PËR SIGURIME SHOQËRORE

Në zbatim të ligjit nr 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar, vlera vjetore e përlllogaritur e këtyre kontributeve (16.7% të fondit të pagës) është 47.835.000lek. Fond i pagave dhe fondi për sigurime shoqërore nga Granti planifikohet në vlerën prej 356.302.000lek. Në këtë fond është parashikuare dhe fond i veçantë në vlerën prej 14.689.000lek, i cili llogaritet automatikisht nga formati i dërguar nga Ministria e Arsimit.

I-3 PLANIFIKIM I FONDEVE PËR SHPENZIME OPERATIVE

Gjithashtu janë planifikuar një pjesë e shpenzimeve operative nga Grandi sipas tabelës:

Nr	Objekti I Prokurimit	Plan buxheti
1	Kosto të seancave të bordeve, senatit, komisione të Dr. etj	7.200.000
2	Shpenzime për qeverinë studentore	3.000.000
3	Energji	2.000.000
4	Ujë	250.000
5	Telefon	400.000
6	Sherbim postar	150.000
7	Aktivitete shkencore, kumtesa, konferenca, projekte të ndryshme, etj	6.000.000
8	Blerje bileta avioni (dieta jashtë vendit)	2.000.000
9	Shërbime të ndryshme, detyrime tarifore bashki, hostim i faqes, etj.	400.000
10	Dieta (brenda, jashtë vendit, ekspedita)	1.800.000
TOTALI		23.200.000

- Në zërin kosto të seancave të bordeve, mbledhje senati, komisioni i doktoraturës, etj është parashikuar nga përllogaritjet në vlerën 7.200.000lek.
 - për pagesat e anëtarëve të Senatit Akademik (për nëntë muaj);
 - për pagesat e anëtarëve të Bordit të Administrimit (për 12 muaj);
 - për pagesat e anëtarëve të Komisionerëve të Doktoraturës.
 - Në zërin kosto të seancave të bordeve, mbledhje senati, komisioni i doktoraturës, etj është parashikuar nga përllogaritjet në vlerën 7.200.000lek.
- Në zërin Shpenzime për Qeverinë Studentore është parashikuar një vlerë prej 3.000.000lek nisur nga rekomandimet e grupit të ekspertëve për akreditim. U pa e arsyeshme të akordohet dhe të menaxhohet ky fond me qëllim aktivizimin dhe mbështetjen e studentëve në veprimtaritë social-kulturore dhe shkencore me impakt universitar për të qënë jo vetëm kontribues për krijimin e të ardhurave për institucionin, por edhe protagonist për veprimtari të cilat kanë një ndikim pozitiv në jetën e Universitetit, qytetit dhe të Rajonit të Jugut, e gjitha kjo mbështetur në nenin 99, pika 6 të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”. Qeveria studentore, stafi akademik si dhe administrativ duhet të sjellë në kohë kërkesat me qëllim planifikimin, pasi vlerat duhet të llogariten të sakta për ti vendosur duke pasur parasysh planifikimet më parë.
- Në zërat energji, ujë janë shpenzime me karakter tarifar dhe është parashikuar përkatësisht: Në zërin e energjisë elektrike është parashikuar një vlerë prej 2.000.000 lek për mjediset ekzistuese. Në këtë vlerë janë planifikuar nisur nga realizimi i këtij zëri në vitet e mëparshme. Për ujin është planifikuar në vlerën 250.000lek duke pasur parasysh realizimin e mëparshëm të fondeve.
- Për zërin telefon parashikohet pagesa për telefoninë fikse dhe për telefoninë celulare, sipas VKM-së nr. 673, datë 2.9.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik” ku lejohen të trajtohen me pagesën mujore punonjësit e Universitetit sipas vendimit të mësipërm dhe kjo vlerë përllogaritet në total 400.000lek, vlerë e cila nuk e tejkalon me 2% të vlerës së përgjithshme të institucionit, të planifikuar për shpenzimet operative, siç kërkohet në këtë vendim.
- Në zërin shërbimi postar, parashikohet në vlerën edhe 150.000 lek, e cila do të përdoret për të përballuar pagesat për shërbimin postar të thjeshtë, por edhe shërbimin me postë të shpejtë për ato raste kur gjykohet nga titullarët se duhet të përdoret ky shërbim.
- Në zërin aktivitete shkencore, kumtesa, konferenca kombëtare, ndërkombëtare, projekte, etj është planifikuar fondi prej 6.000.000 lek, për ti dhënë përparësi kërkimit shkencor nëpërmjet projekteve shkencore, aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Në zërin blerje bileta avioni (dieta jashtë vendit) është parashikuar në një vlerë totale prej 2.000.000 lek. Në kuadrin e Ndërkombëtarizimit të Universiteteve do të përballshet lëvizja e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ jashtë vendit por edhe për seminare, trajnime, konferenca, aktivitete dhe projekte të ndryshme.

- Në zërin shërbime të ndryshme (detyrime tarifore bashki, hostim, pagesa që mund të dalin në vijim kosto legale, dhurata, etj) janë parashikuar në vlerën prej 400.000 lek dhe janë planifikuar këtu për kryerjen e shpenzimeve për shërbime të ndryshme që janë të domosdoshme për funksionimin e institucionit si: akte teknike (të mbrojtjes nga zjarri, të raporteve higjeno-sanitare), hostim të faqes së UGJ, dhe shërbime të tjera të cilat mund të jenë specifike për një vit buxhetor, etj.
- Në zërin dieta brenda e jashtë vendit, ekspedita është parashikuar në një vlerë totale prej 1.800.000 lek, ku do të përballohet kryerja e praktikave mësimore (ekspedita) të studentëve si edhe lëvizja e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ jashtë rrethit dhe jashtë vendit për seminare, trajnime, konferenca, aktivitete dhe projekte të ndryshme.

II. FINANCIM NGA TË ARDHURAT DYTËSORE

Burimi kryesor i krijimit të ardhurave dytësore janë pagesa e tarifës së shkollimit nga studentët. Për vitin 2026 parashikojmë 45.654.000lek, limit ky i përlllogaritur në bazë të numrit aktual të studentëve për vitin akademik 2024-2025, si dhe të kuotave pritëse për vitin akademik 2025-2026. Nga tabela e Aneksit 7 duket qartë se ne planifikojmë mbi bazën e kuotave të planifikuara dhe të miratuara në senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit. Niveli i të ardhurave i llogaritur mund të jetë i ndryshëm nga fakti, mund të jetë më i ulët apo edhe disi pak më i lartë, sepse jo të gjithë studentët që parashikojmë do të regjistrohen në të dy ciklet e studimit, por mund të kemi edhe prurje më shumë në vitin akademik 2025-2026. Realizimi i këtij niveli të ardhurash mbart në vetvete risk, pasi llogaritja e tyre është bërë në bazë të kuotave pritëse. Praktika ka dëshmuar se gjithmonë ka mos plotësim të shifrave të planifikuara, ose mund të ketë raste kur kuotat plotësohen dhe studentët regjistrohen, por nuk frekuentojnë procesin mësimor. Siç është vënë në dijeni, për të shmangur këtë problem dhe për të minimizuar riskun e arkëtimit të të ardhurave nga ana e Administratorit në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, është marrë vendim që studentët të paguajnë tarifën së shkollimit sipas programit të studimit përkatës në momentin e regjistrimit përfundimtar, pasi aplikanti fiton statusin e studentit.

Planifikimi i shpenzimeve nga të ardhurat për vitin 2026 bëhet duke pasur parasysh:

- Financimin e akreditimit institucional, pasi në datën 15 dhjetor të vitit 2025 përfundon akreditimi i mëparshëm.
- Financimin e aktiviteteve akademik dhe administrativ të institucionit mbi baza reale dhe nevoja të domosdoshme të funksionimit të tij.
- Financimin e aktiviteteve (ose shpenzime) me karakter të drejtpërdrejtë për forcimin dhe thellimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- Financimin për mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucionit dhe të sistemit të të dhënave që është implementuar në Universitet.
- Financimin për aktivitete shkencore të Njësive Bazë dhe Njësive Kryesore, pasi nga produktet e tyre do të kenë përfitim të drejtpërdrejtë komuniteti i qytetit dhe i Qarkut të Gjirokastrës dhe më gjerë.

- Financime për qeverinë studentore për aktivitete të ndryshme me karakter social, apo bashkëpunues me qeverinë studentore të universiteteve të tjera.

Si edhe :

- Përbushjen e të gjitha standarteve mbi të cilat do të realizohet akreditimi i institucionit në vazhdim.
- Integrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore me atë të mësimdhënies në nivele bashkëkohore praktike dhe teorike.
- Rritjen e nivelit të njohurive dhe aftësimin profesional të studentëve.
- Mundësinë e rritjes së qëndrueshme afatmesme të të ardhurave të institucionit, megjithëse në këto kushte është shumë e vështirë.

II-1 PLANIFIKIM I FONDEVE PËR PAGA

Duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave nevojitet për tu shpenzuar për paga është planifikuar në vlerën prej 30.860.000lek me qëllim përballimin e pagesave të:

- Orëve suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës mësimore sipas udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018 të MAS-it, si dhe VKM nr 748, datë 11.6.2009 të ndryshuar.
- Orëve të pedagogëve të ftuar dhe të jashtëm.
- Diferencën e pagave për muajt që nuk mund të mbulohet nga limiti i miratuar nga MA-ik.

Ky fond është planifikuar në nivele sipas strukturës së miratuar, por mendojmë se mund të bëhet:

- riorganizimi i studimeve të ciklit të parë Bachelor nga 18 në 9, si edhe rritja e numrit të pedagogëve të jashtëm, për ato lëndë që nuk mund të mbulohen me staf të brendshëm.

II-2 PLANIFIKIM I FONDEVE PËR SHPENZIME OPERATIVE

(Shpenzime për mirëmbajtjen dhe funksionimin e institucionit)

Nr	Objekti i Prokurimit	Shpenzime	Plan të ardhura
1	Diploma studenti		500.000
2	Akreditimi i programeve mësimore dhe institucionale 2.077488lek dhe pagesa për ekspertët 266250lek		2.343.976
3	Shërbim postar		50.000
4	Abonim për shërbiminterneti		120.000
5	Dezinfektim i ambienteve		240.000
6	Sigurimi i detyrueshëm i mjeteve autoveturë M-Benz, furgon M-benz		200.000
7	Rimbushje bombola gazi		120.000
8	Shërbime të printimit dhe publikimit buletine		600.000
9	Kosto reklam dhe publikimi (spote, aktivitete, etj)		300.000
10	Kancelari		500.000
11	Bojra (fotokopje, printeri)		600.000
12	Materiale pastrimi		500.000
13	Materiale elektrike, hidraulike dhe ndërtimi		1.200.000
14	Mirëmbajtje mjete transporti (dy mjete)		400.000
15	Mirëmbajtje të aparateve kondicionerë		120.000
16	Shërbime të ndryshme (detyrime tarifore, bashki, hostim, kosto legale, etj)		500.000
17	Trasferta të jashtme 605		500.000
18	Shpenzime pritje e përcjellje		700.000
19	Blerje karburant		1.200.000
20	Diploma studenti		500.000
	Totali i shpenzimeve operative		11.193.976

Këto shpenzime do të mbulohen nga të ardhurat dytësore, është planifikuar një vlerë që mbulon nevojat e domosdoshme të institucionit për gjithë vitin kalendarik 2026, pasi nevojat janë më të mëdha se sa planifikimi që ne kemi bërë. Sipas tabelës së mësipërme argumentojmë planifikimin e nivelit të fondit për çdo zë:

- Në zërin *Diploma* studenti parashikohet në vlerën prej 500.000lek. Kjo vlerë është planifikuar nisur nga numri i studenteve, kërkesat e viteve të mëparshme si dhe faktin se kemi programe të reja për të cilat nuk është miratuar akoma forma e diplomës. Për rrjedhojë këto diploma do të prodhohen në vitet në vazhdim.
- Në zërin *akreditimi i programeve mësimore dhe institucionit* janë planifikuar në vlerën prej 2.343.976lek si rezultat i rekomandimeve të lëna nga grupi i akreditimit si edhe për të likuiduar në kohë çdo aplikim për program të ri që mund të ketë gjatë vitit 2026.
- Në zërin *shërbimi postar*, parashikohet në vlerën 50.000lek për të përballuar pagesat për shërbimin postar të thjeshtë kryesisht, por edhe shërbimin me postë të shpejtë për ato raste kur gjykohet nga titullarët se duhet të përdoret ky shërbim.
- Në zërin *abonim për shërbim interneti* janë planifikuar në vlerën prej 120.000 lek duke pasur si prioritet shërbimet që ofrohen nëpërmjet internetit si edhe faktin se të gjitha veprimet me thesarin kryhen nëpërmjet sistemit AFMIS.
- Në zërin *dezinfektimi i ambienteve* janë planifikuar në vlerën prej 240.000 lek. E kemi detyrim ligjor që dezinfektimi i ambienteve të kryhet si edhe të certifikohet çdo 6 muaj.
- Në zërin *sigurimi i detyrueshëm i mjeteve* janë planifikuar në vlerën prej 200.000 lek duke patur parasysh siguracionin vjetor faktik si dhe ndryshimet që mund të ndodhin gjatë vitit 2026.
- Në zërin *rimbushje fikse zjarri* janë planifikuar në vlerën prej 120.000 lek për rimbushjen e fikseve të zjarrit.
- Në zërin *shërbime të printimit dhe publikimit* janë planifikuar në vlerën prej 600.000lek. Një vëmendje e veçantë i kushtohet nga UGJ-ja promovimit të Universitetit gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave institucionale. Do të përballohen shpenzimet për përgatitjen dhe botimin e periodikut “Kërkime Universitare”, botimin e përmbledhjes së recencave të konferencës ndërkombëtare që u zhvillua në vitin 2025, si edhe shtypshkrime të tjera konkarta, fletpalosje, etj. Gjithashtu janë planifikuar në këtë vlerë pasi mund të kemi bashkëpunime me institucione të ndryshme për zhvillimin e konferencave të tjera shkencore si dhe për t’i paraprirë vështirësisë financiare të ekzekutimit të këtyre shpenzimeve. Gjithashtu, janë planifikuar jo vetëm mbi eksperiencat e viteve të kaluara, me qëllim mos pengimin e bashkëpunimit të institucionit tonë me partnerë të tjerë, por duke qenë se nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe kërkimin Shkencor janë planifikuar për vitin 2026 një pjesë e konsiderueshme aktiviteteve. Gjithashtu këtu planifikohen fletë palosje për promovimin institucional apo edhe shpenzime të tjera që mund të jenë të paparashikuara më parë.
- Në zërin *kosto reklamimi dhe publikimi* (spote, aktivitete, etj) është parashikuar vlera prej 300.000 lek.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet nga ana jonë promovimit të Universitetit gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave si më poshtë:

- a) rritjen e numrit të studentëve;
- b) rritjen e impaktit pozitiv në komunitetin e rrethit të Gjirokastrës dhe më gjerë;
- c) rritjen e kontributit në jetën dhe cilësinë e jetesës së këtij komuniteti.

➤ *Në zërin Kancelari, bojra fotokopje e printeri*, parashikohet përkatësisht në vlerën prej 500.000 lek për kancelari dhe 600.000 lek për bojra për të përballur furnizimin e institucionit me bazë materiale kancelarike, tonera etj. Një peshë të konsiderueshme zënë tonerat e printerave dhe fotokopjuesve, të cilat kanë një kosto më të lartë në treg. Duke qenë se në çdo Njësi Bazë kemi si printera (ku në çdo Njësi Bazë përbëhet nga një numër i konsiderueshëm staf akademik) ashtu edhe fotokopjues, gjithashtu edhe zyrat e administratës janë të pajisura me printera dhe fotokopje për të cilat duhet të planifikojmë disa bojra në vit në varësi të kërkesave si dhe volumit të punës që ka çdo zyrë.

Në zërat e tjerë parashikohet në vlerat si më poshtë:

- *Në zërin Materiale pastrimi* 500.000 lek, mirëmbajtje kondicioner 120.000 lek, kurse në zërin materiale hidraulike, elektrike e ndërtimi parashikohet 1.200.000 lek me qëllim mirëmbajtjen e klasave dhe riparimin e tyre (ndërrim pllakash).
- *Në zërin mirëmbajtje mjete transporti* parashikohet në vlerën prej 400.000 lek. Ashtu si edhe më parë peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve siç edhe ju kemi vënë në dijeni e zë automjeti i tipit furgon pasi është blerë prej vitesh dhe ka një amortizim më të lartë nga viti në vit, për shkak të vjetërsisë dhe përdorimit të shpeshtë. Me të ardhurat që realizon institucioni, është planifikuar blerja e një mjeti të ri, pasi edhe nga vlerësimi i tregut për blerjen e këtyre mjeteve të transportit do të ketë një kosto të konsiderueshme, shumë herë më të lartë se vlera e mirëmbajtjes së tij. Në vijim të vitit 2025 nuk do të arrihet që të realizohet blerja. Në këto kushte planifikojmë përsëri blerjen në vitin 2026 si edhe mirëmbajtjen e mjeteve që kemi aktualisht (*planifikohet blerja e mjetit nga të ardhurat krijuara për vitin 2026*). Gjithashtu është planifikuar edhe për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të transportit si dhe taksat vjetore në vlerën prej 200.000 lek.
- *Në zërin shërbime të ndryshme* (detyrime tarifore bashki, hostim, pagesa që mund të dalin në vijim kosto legale, dhurata, etj) është parashikuar vlera prej 500.000 lek. Gjithashtu, është planifikuar këtu për shpenzimet bankare dhe pjesa tjetër parashikohet për kryerjen e shpenzimeve për shërbime të ndryshme që janë të domosdoshme për funksionimin e institucionit si: akte teknike (të mbrojtjes nga zjarri, të raporteve higjieno-sanitare), hostim të faqes së UGJ, dhe shërbime të tjera të cilat mund të jenë specifikisht për një vit buxhetor.
- *Në zërin shpenzime për pritje përcjellje* kemi planifikuar një fond prej 700.000 lek duke marrë parasysh edhe shpenzimet në vitet e mëparshme në Universitet.
- *Në zërin karburant* parashikohet në vlerën prej 1.200.000 lek, nisur kjo nga:
 - sasia e karburantit që është gjendje;



- krijimin e kushteve optimale jo vetëm në ambientet e zyrave ku kanë edhe ngrohje alternative, por edhe për sallat e leksioneve dhe seminareve, duke ju përgjigjur edhe kërkesave të studentëve për ngrohje;
 - sasia e nevojshme për mjetet e transportit.
- Për zërin *pagesa për RASH* është planifikuar një fond prej 500.000 lek. Për vitin 2023 është lidhur kontrata, e cila do të ketë efektin financiar në vijimësi, sipas përcaktimeve në të dhe shërbimeve që do të ofrohen në institucion. Kjo tarifë është e vendosur në kontratën e shërbimit.
- Për zërin “*Trasferta të jashtme*” 605, parashikohet në vlerën prej 500.000lek për arsye të aderimit të institucionit në organizata ndërkombëtare akademike, të cilat rrisin prestigjin e institucionit, parë kjo si një domosdoshmëri edhe për procesin e akreditimit të Universitetit. Kemi planifikuar abonime të cilat janë konsideruar prestigjoze për faktin që kanë ndikim pozitiv për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe azhurnimin me literaturë bashkëohore të stafit akademik, si dhe për zhvillimin e karrierës së mëtejshme të tyre. Abonimi në organizatën Universitare Ndërkombëtare “International Association of Universities” prej shumë vitesh, ku kemi edhe të drejtë votimi për vendimet që merren në këtë organizatë, pagesa vjetore për abonimin në shoqatën e Matematikës, abonimi në shoqatën ekonomike të universiteteve Asecu, abonimi në rrjetin e Universiteteve Adrion. Në qoftëse gjatë vitit pranë zyrës së Administratorit do të paraqiten kërkesa nga Njësitë Bazë për abonime të tjera, ato do të trajtohen si gjithmonë me përparësi.

I-4 PLANIFIKIM I FONDEVE PËR INVESTIME NGA TË ARDHURAT

Për investime janë parashikuar në vlerën prej 6.600.000lek sipas tabelës:

Nr	Objekti i Prokurimit	Investime	Plan të ardhura
		Plan buxheti	
1	Libra për bibliotekën dhe për studentët		1.200.000
2	Blerje automjeti 4-vendesh elektrik		3.000.000
3	Blerje pajisje klasash (banka, tavolina, karrige) si dhe orendi zyre (sallon, perde, tavolinë, karrige në rektorat)		1.200.000
4	Mirëmbajtje klasash (vendosje pllakash)		1.200.000
Totali i investimeve			6.600.000

- Në zërin *libra për bibliotekën dhe studentët* është parashikuar fondi prej 1.200.000 lek për blerjen e një kontigjenti librash për bibliotekën që do tju shërbejë stafit akademik si edhe studentëve. Rritja e fondit të librave përmbush një nga rekomandimet e lëna nga grupi i ekspertëve të akreditimit institucional si dhe përmbush nevojat në kuadrin e ndërkombëtarizimit të universiteteve (Doktoraturë e përbashkët me universitetin e Maqedonisë Perëndimore dhe programe të përbashkëta Bachelor dhe Master me universitetet e Italisë).
- Në zërin *blerje automjeti* është parashikuar fondi prej 3.000.000 lek. Mjeti tip benz me targa AA900 CF, i cili është në pronësi të universitetit ka nevojë që të zëvendësohet, e cili ishte planifikuar për tu blerë në vitin 2025, por për arsye të pamjaftueshmërisë së fondeve nuk mund të realizohet blerja sivjet.

- Në zërin pajisje zyre është parashikuar një fond prej 1.200.000 lek kryesisht për blerje banka dhe karrige për studentët, tavolina, podiume etj, pajisje këto të domosdoshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe rritjen e efikasitetit të infrastrukturës së institucionit. Gjithashtu zyra e Rektoratit ka nevojë për zëvendësimin e pajisjeve (salloni, perdet, tavolinat, karriget).
- Në zërin mirëmbajtje klasash (vendosje pllakash) është parashikuar fondi prej 1.200.000 lek. Parashikojmë në këtë vlerë për arsye se disa klasa duhen rikonstruktuar dhe më pas të zëvendësohen bankat dhe karriget.

Parashikimi i zërave buxhetorë për vitin 2026

Nr	Emërtimi i zërave të Buxhetit	Llogaria	Viti 2026		
		Ekonomike	Total	Njëmijë lek	
I	Granti dhe të ardhura		Njëmijë lek	Buxhet	Të ardhura
1	Paga personeli, orë suplementare, orë pedagogë të jashtëm e të ftuar.	600+604	336,326	308,466,5	27,860
2	Sigurime shoqërore	601	47,835	47.835,5	0
A	SHUMA	600 + 601	384,162	356,302	27,860
3	Shpenzime për funksionimin mësimor dhe administrativ të institucionit	602	33,894.00	23,200	10,694
4	Trasferte për pjesëmarrje në konferenca	605	500.00	0.00	500
B	SHUMA	602+605	34,394.00	23,200.00	11,194.00
C	Bursa për studentët	606	16,500	16,500	0
D	Investime nga të ardhurat (rikonst ,libra, blerje mjet)	231	6,600		6,600
5	Investime nga Granti	231	0	0	0
6	(Projekte)	230	0	0	
E	Shuma investime granti dhe të ardhura 230+231	230+231	6,600	0	6,600
	Totali i investimeve		441,656	396,002	45,654

Njësoj është parashikuar edhe për vitet 2027 dhe 2028, por duke qënë se bëhet parashikimi çdo vit do të kemi ndryshime që do të pasqyrohen në vitet në vijim, nuk i shtojmë tabelat 2027, 2028.

Tabela nr. 21: Për planin buxhetor afatmesëm

Të dhëna për planin Buxhetor Afatmesëm			
Grante nga Buxheti i Shtetit			
Emërtimi i projektit	Viti Paraardhës	Viti i Pritshëm	Viti Parashikim 2026
Granti për Mësimdhënien	300,552	301,337	396,002
Granti për Punën Kërkimore	3,666	1,437	
Granti për Projektet e Zhvillimit		-	
Totali	304,218	302,774	396,002
Disbursime të projekteve të huaja			
Emërtimi i projektit	Viti Paraardhës	Viti Aktual	Viti Pasardhës
Disbursime të huaja për shpenzime korente	7,680	14,385	3,295
Disbursime të huaja për investime		249	
Rimbursim nga donatori			
Disbursime të huaja për shpenzime korente			
Totali	7,680	14.634	3,295
Disbursime të projekteve të huaja			
Emërtimi i projektit	Viti Paraardhës	Viti Aktual	Viti Pasardhës
Fondet nga të ardhurat për shpenzime korente			
Fonde nga të ardhurat për investime			
Kostot Lokale per Projektet me Financim të Huaj			
Qera		132	132

Profesionale 2-vjeçare						
Bachelor	14,571		14,830			14,830
DIND						
Master Profesional	26566.4		24,181			24,181
Master i Shkencave	1314		959			1,499
Doktoraturë			450			2,450
Trajnimi mësuesve						
Libreza Diploma etj.			-			
Lëshim dokumenti						
Taksë regjstrimi	1565		2110			2,110
Tarifa konkurrimi						
Tjera - shërbime	0		-			
Pjesm. konferenca			0			
Sponsorizime	5,073		0			450
Totali	49,090		42,662			45,652
Efektet financiare nga VKM-të						
Emërtimi	Viti Paraardhës		Viti Aktual		Viti Pasardhës	
	Nr. Studentë	Vlera	Nr. Studentë	Vlera	Nr. Studentë	Vlera
VKM nr. 903, datë 21.12.2016	127	9,930	134	6,630	193	13,300
VKM nr. 288, datë 21.05.2018	761	7,610	870	17,100	875	8,750
VKM nr. 269, datë 29.03.2017	96	1,340	72	890	96	1,340
VKM nr. 386, datë 01.06.2022	7	1800	7	2,400	8	3,200.0
Totali	991	20,680	1083	27,020	1172	26,590
Shpenzime						
Emërtimi i projektit	Viti Paraardhës		Viti Aktual		Viti Pasardhës	
Fondet nga të ardhurat për shpenzime korente	10,585		5,271		11,195	
Paga e shpërblime	259,598		261,009		336,326	
Pagat						
Honorare - orët						
Sig. Shoqërore	40,600		36,212		47,835	
Shpenzime operative	23,002		11,946		23,200	
Transf. me jashtë	250					
Transf. individët					0	
Bursa	11,480		9,030		16500	
Kërkimi shkencor	1,697		1,094			
Investime			911			
Studim projekte, softe						
Studime e projekte						
Patenta, softe kompjuterike						
Investime trupëz.						
Ndërtime të reja						
Rikonstruksione						
Instalime rrjete						
Makineri teknologjike						
Paisje profesionale						
Pajisje inventar ekonomik					6,600	
Mjete transporti						
Projekte të huaja						
Shpenzime korente			442			
Shpenzime, Investime			632			
Ridisbursim i projekteve të huaja						
Totali	347,212		326,547		441,656	

Në tabelën nr. 22, paraqitet një pjesë e konsiderueshme e buxhetit, fonet e alokuara, shpenzimet operative për procesin mësimor dhe administratën, dhe bilancin e mbetur për secilin zë (pagat e personelit, orët jashtë orarit, orët me kohë të pjesshme, sigurimet shoqërore, pjesëmarrje në konferencë, bursa për studentë, investime, etj.

Tabela nr. 22: Për planin buxhetor njëvjeçar

Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkruese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë minimalisht të dhënat e paraqitura në tabelat si më poshtë për vitin buxhetor pasardhës (1 janar- 31 dhjetor):

Plani buxhetor njëvjeçar i të ardhurave				000/lekë
Nr	Emërtimi i Projektit	Mbartur nga viti paraardhës	Financimi i vitit aktual	Buxheti vitit
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit			0
1.1	Granti mësimdhënies		379,502	379,502
1.2	Granti i bursave të studentëve cikli parë		16,500	16,500
1.3	Granti Konkurrues			
1.4	Granti Kërkimit shkencor			
1.5	TVSH- Projekte të huaja			
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj			
2.1	Disbursime të huaja për shpenzime korente			
2.2	Disbursime të huaja për investime			
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar			
3.1	Të ardhura për shpenzime korente		39,054	39,054
3.2	Të ardhura për investime		6600	6600
3.3	Të ardhura për kërkim shkencor			
Totali			441,656	441,655

Plani buxhetor njëvjeçar i shpenzimeve					000/Lekë
Nr	Emërtimi shpenzimit	Grant	P/huaja	Të ardhura	Total Buxheti
	Paga e shpërblime		0		
-	Pagat	308,466		27,860	336326.4
-	Honorare - orët				0
2	Sig. Shoqërore	47,835			47,835
3	Shpenzime operative	23,200		10,694	33,894
4	Transf. me jashtë			500	500
5	Transf. individët				0
6	Bursa	16,500			16,500
7	Kërkimi shkencor				0
-	Kërkimi shkencor				0
8	Investime				0
a	Studim projekte, soffte				0
-	Studime e projekte				
-	Patenta, soffte kompjuterike				0
b	Investime trupëz.				0
-	Ndërtime të reja				0
-	Rikonstruksione				0
-	Instalime rrjete				0
-	Makineri teknologjike				0
-	Paisje profesionale				0
-	Paisje inventar ekonomik			6600	6600
-	Mjete transporti				0

9	Projekte të huaja				0
-	Shpenzime korente				0
-	Shpenzime Investime				0
-	Ridisbursim i projekt huaj				0
	Totali	396,002	0	45,654	441,656

Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit

Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkruese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

Qëllimet dhe objektivat e planit strategjik të institucionit në fushën e mësimdhënies dhe në fushën e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit, si dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e tyre.

c) Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.

Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkruese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë tabelat, sipas modeleve të parashikuara në aktet nënligjore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financës, dhe afatet e përcaktuara.

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 32, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit të përbashkët Nr.20 datë 20.09.2019 të MA dhe MFE “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; VKM-së Nr.75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, të zbatimit të buxhetit, konform miratimeve, nga Bordi i Administrimit të Universitetit “Eqrem Cabej”, edhe në vitin 2024 aktiviteti financiar është bazuar në dy burimet e financimit si më poshtë vijon:

- 1-Financimin nga Buxheti i Shtetit në vlerën prej 292.372.962 lekë çelur në fillim të vitit 2024.
- 2-Financimin nga të ardhurat e Institucionit në vlerën prej 49.023.260 lekë.

I-Financimi nga buxheti i shtetit:

Për 2024 janë përballuar nga Buxheti i Shtetit:

- 1- Pagat e stafit akademik me kohë të plotë si edhe të ftuar e të jashtëm, të stafit administrativ, punonjësve mbështetës, sipas strukturës organike të miratuar. Nga fondi i pagave gjatë vitit 2024 është alokuar fondi në vlerën prej 249.550 lekë, për të dhënë shpërblime për raste të veçanta (dalje në pension). Edhe ky fond është realizuar në masën 100%.
- 2- Pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëdhënësi është realizuar në masën 100 %.
- 3-Pagesa për bursat e studentëve 79%.
- 4-Pagesa për shpenzimet operative 100 %.
- 5-Pagesa për projektet e financuara nga AKSHI 46,30%.

Fondet nga Buxheti i Shtetit të akorduar për vitin 2024, nuk kanë qënë të mjaftueshme për të përballuar pagat dhe sigurimet shoqërore të të gjithë vitit, për rrjedhojë një pjesë të pagave të punonjësve si edhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësorë u paguan nga të ardhurat e krijuara.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve me fonde nga Buxheti i Shtetit të ndarë sipas zërave jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtesa	Viti 2024		
		Plani	Realizimi	% e realizimit me planin fillestar
1	Fondi i pagave	224.342.422	224.342.422	100%
2	Sigurime shoqërore	37.417.334	37.417.334	100%
3	Bursa e transferime	12.220.000	9.679.973	79%
4	Bursa prioritare 2023-2024	1.800.000	1.800.000	100%
5	Bursa prioritare 2024-2025	2.520.000		
6	Transferime fond i vecantë	249.550	249.550	100%
7	Fonde nga AKSHI për shpenzime operative	3.666.070	1.697.411	46.30%
8	Fonde për shpenzime operative	23.002.077	23.002.077	100%
	Gjithsej shpenzime	305.217.453	298.188.767	97.70%

Siç shihet edhe nga tabela, realizimi i shpenzimeve me fonde nga Buxheti i Shtetit është në masën 97.7%. Fonde të papërdorura, të cilat do të trashëgohen në vitin buxhetor 2025 janë si më poshtë:

1-Fonde për bursa 5.060.024 lekë nga të cilat 2.520.000 janë për studentët që studiojnë në degët prioritare dhe thesari nuk e ka konfirmuar në kohë këtë fond të çelur në dhjetor dhe 2.540.024 lekë është fond i cili nuk u realizua për studentët përfitues të bursave dhe vijnë nga shtresat sociale në nevojë apo edhe studentë ekselentë, të cilët përfitojnë sipas VKM nr. 903/2016 të ndryshuar me VKM nr. 39/2019.

2-Fonde për projektet e përfituara dhe të financuara nga AKSHI në vlerën prej 1.968.659 lekë. Këto projekte vijojnë edhe për këtë vit buxhetor.

Në total nga fondet e buxhetit trashëgohen 7.028.683 lekë për përdorim në vitin 2025.

II-Financimi nga të ardhurat dytësore:

Të ardhurat e krijuara për Universitetin në vitin 2024 janë burim tjetër financimi. Ato janë përdorur për paga, sigurime dhe shpenzime operative.

Të ardhurat dytësore për vitin 2024 janë realizuar sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Të ardhurat progresive
1	Të ardhura nga qera për ndërtesa	
2	Tarifa për akte administrative	846,875
3	Tarifa shkollimi	42,314,038
4	Të tjera të ardhura sekondare	255,789
5	Tarifa për rregjistrim në arsim të lartë	62,500
6	Të tjera tarifa	533,814
7	Të tjera të ardhura sekondare (projektet)	5,073,167
	Total	49,086,183.10

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme për vitin 2024, të ardhurat janë realizuar në vlerën 49.086.183,10 lekë gjithsej sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit, por në fakt të ardhurat e mirëfillta janë 43.175.326,44 lekë, sepse vlera prej 5.073.167 lekë janë të ardhura nga pagesat e donatoreve për projektet me financim të huaj.

Vlera tjetër prej 837.690 janë të ardhura për pagesën e trajnimit të mësuesve, të ardhura enkas nga ASCAPI. Rritja e arkëtimit të të ardhurave ka ardhur si rrjedhim i ndryshimit të mënyrës së pagesave nga studentët të kësteve të tarifës së shkollimit. Ky ndryshim u bë me vendim të Bordit të Administrimit, pasi burimi kryesor i të ardhurave për institucionin janë të ardhurat nga studentët, të krijuara kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe tarifat e rregjistrimit të tyre. Duke analizuar të ardhurat e realizuara të Universitetit gjatë viteve të fundit ato kanë pësuar luhatje, me ndryshimin se për vitin akademik 2023-2024 ka patur rritje të numrit të studentëve të rregjistruar për herë të parë.

Numri i studentëve të regjistruar ka pasur luhatje përkatësisht si më poshtë vijon:

për vitin akademik 2015-2016, 1770 studentë
për vitin akademik 2016-2017, 1626 studentë
për vitin akademik 2017-2018, 1454 studentë
për vitin akademik 2018-2019, 1521 studentë
për vitin akademik 2019-2020, 1501 studentë
për vitin akademik 2020-2021, 1489 studentë
për vitin akademik 2021-2022, 1324 studentë
për vitin akademik 2022-2023, 1302 studentë
për vitin akademik 2023-2024, 1213 studentë
për vitin akademik 2024-2025 1359 studentë

Siç vihet re ka një rritje të numrit të studentëve në dy vitet e fundit, por gjithmonë ka studentë që rregjistrohen dhe nuk frekuentojnë procesin mësimor dhe për rrjedhojë nuk paguajnë as tarifën e shkollimit, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në të ardhurat e planifikuara të Institucionit. Në rritjen e arkëtimit të tarifave të planifikuara është bërë një punë e konsiderueshme nga të gjithë, si nga stafi akademik, ashtu edhe nga stafi administrativ, por në vazhdim duhet që të ardhurat të arkëtohen në kohë. Mosarkëtimi ndikon drejtpërdrejt në likuidimin në kohë të pagave, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në likuidimin e pagesave të Senatit Akademik, të Bordit të Administrimit, të orëve suplementare, si dhe të shpenzimeve të tjera të domosdoshme të planifikuara për vitin 2025. Një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave kryesisht nga arkëtimi i tarifës së shkollimit të studentëve, janë arkëtuar në muajt nëntor-dhjetor 2024.

Trajtimi i një numri të madh studentësh, të cilët vijnë kryesisht nga shtresa sociale në nevojë, me prindër invalid apo edhe vetë studentët me PAK, për rrjedhojë nuk e paguajnë ose e paguajnë pjesërisht tarifën e shkollimit sipas sistemit të studimit përkatës. Nga viti 2023 janë trashëguar 189.931,92 lekë të ardhura; gjatë vitit 2024 janë krijuar 49,086,183.10 lekë nga të ardhurat; gjatë vitit 2024 janë përdorur 49,023,260.00 lekë nga të ardhurat, ndërsa për vitin 2025 trashëgohen 252.855,02 lekë të ardhura.

Prafitja e të ardhurave të krijuara në vite, si më poshtë vijon:

Viti 2018: 40.870.305 lekë
Viti 2019: 32.703.468 lekë
Viti 2020: 33.298.983 lekë
Viti 2021: 47.299.967 lekë
Viti 2022: 41.493.649 lekë



Viti 2023: 44.559.561,92 lekë

Viti 2024: 43.175.326,44 lekë

Siç vihet re ka një luhatje në vlera ku, për vitin 2024 ka një rritje të të ardhurave. Kjo rritje është rrjedhojë e pagesës së fondeve nga donatorë për projektet me financim të huaj, pasi një pjesë e shpenzimeve të projekteve janë paguar nga të ardhurat e institucionit.

Ky ka qënë një kusht i vendosur nga donatorët, me qëllim thithjen e të gjitha fondeve të planifikuara për shpenzime të projekteve me financim të huaj. Gjithashtu arkëtimi në rritje i të ardhurave është edhe rrjedhojë e pagesës së kështit të parë të tarifës së studimit nga studentët që ndjekin ciklin e dytë të studimeve *Master*, me 30.000 lekë, sipas vendimit të BA (kësti i parë ka qënë 10.000 lekë).

Shpenzimet nga të ardhurat e Institucionit janë në vlerën prej 49.023.260 lekë, e ndarë sipas zërave në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtesa e shpenzimeve	Viti 2024		
		Planifikimi	Realizimi	% e Realizimit me planin fillestar
1	Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore	38.502.185,63	38.437.905,00	99.80
2	Shpenzime Operative dhe abonime	10.773.929,39	10.585.355,00	98.20
	Total	49.276.115,02	49.023.260,00	99.48

I- Financimi nga të ardhurat dytësore për pagat.

Këtu janë përfshirë pagat e një pjese të punonjësve për muajin janar që u likuidua në shkurt, orët suplementare për dy fakultetet sipas udhëzimit përkatës të MA, nr 29, datë 10.09.2018, të ndryshuar, paga për orët e pedagogëve të jashtëm dh të ftuar.

Me fondin e mësipërm të pagave janë mbuluar të gjitha shpenzimet sipas shkresave të ardhura nga Njësitë Kryesore dhe Njësitë Bazë për punonjësit efektiv dhe ata të jashtëm e të ftuar për vitin 2023-2024, pas miratimit në BA, si dhe pagat e muajit nëntor paguar në dhjetor.

Duhet theksuar se për arsye të fondeve nuk janë likuiduar sigurimet për pedagogët e ftuar dhe të jashtëm si edhe orët suplementare për Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

II-Financimi nga të ardhurat dytësore për shpenzimet operative dhe të tjera:

Shpenzimet operative për vitin 2024 janë mbështetur pjesërisht nga të ardhurat e institucionit. Fondi i realizuar për shpenzimet operative është në masën 10.585.355,00 leke.

Gjatë vitit 2024 janë bërë ndryshime me vendim të Bordit të Administrimit sipas nevojave brenda limitit të përdorimit.

Në tabelë është dhënë planifikimi dhe realizimi sipas zërave, me të gjitha ndryshimet përkatëse të miratuara gjatë vitit nga Bordi i Administrimit. Për një pjesë të shpenzimeve operative, si dhe për investimet e planifikuara, siç shihet, të ardhurat e krijuara përbëjnë burimin e vetëm.

Fondet që akordohen nga Buxheti i Shtetit nuk mjaftojnë për mbulimin e pagave dhe sigurimeve. Me të ardhurat e trashëguara, si dhe një pjesë të të ardhurave të krijuara u financuan shpenzimet për kontratat e prokuruar, për shpenzimet me blerje me vlerë të vogël, etj. Të gjitha shpenzimeve të planifikuara nga të ardhurat e institucionit, si edhe nga Buxheti i Shtetit iu është dhënë një rëndësi e veçantë përdorimit me efektivitet të tyre, me qëllim realizimin e shpenzimeve më të domosdoshme.

Në tabelën nr. 23, të dhënat janë për periudhën 01.12.2024-31.12.2024

100

